



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 47 dt.30.04.1996

PER
RISTRUKTURIMIN E ZYRËS SE VETERINARISE
NE DREJTORI VETERINARIE

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të dt.30.04.1996, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Zyra e Veterinarisë “Për ristrukturimin e Zyrës së Veterinarisë në Drejtori Veterinarie”, në mbështetje të nenit.14, të ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”,

VENDOSI

1. Të ristrukturohet Zyra e Veterinarisë së Bashkisë në Drejtori Veterinarie sipas seksioneve të mëposhtme :
 - 1.Seksioni Shëndetit Publik Veterinar i përbërë prej 4 personash.
 - 2.Seksioni Shëndetit Publik dhe zoonozave i përbërë prej 5 personave.
2. Të dy seksionet do të kenë nga një përgjegjës i cili do të mbulojë njëkohësisht edhe një detyrë si inspektor.
3. Struktura e dy seksioneve, duke përfshirë këtu dhe drejtorin do të përbëhet nga gjithsej 10 persona nga 8 që ka sot.

4. Dy vendet shtesë do të kompletohen me faza sipas mundësive që ka Bashkia.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Zyra e Veterinarisë si dhe Drejtoria Personel – Organizimit.
6. Ky vendimi hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA